



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

14-020104-129310/24, më 02 OCT 2024

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet themelimi i Komitetit koordinues për zbatimin e Partneritetit për Qeverisje të Hapur - Plani Kombëtar i Veprimit 2023 - 2025.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, komiteti koordinues është në këtë përbërje:
  1. Edis Prapashtica, Sektori i Burimeve Njerëzore, kryesues;
  2. Arlinda Kastrati, përfaqësuese nga ekzekutivi, anëtare;
  3. Gresa Deda, Drejtorja e Administratës, Sektori i TI-së, anëtare;
  4. Betim Abdullahu, Zyra për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
  5. Veton Isufaj, Drejtorja e Financave, anëtar.
3. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi, komiteti koordinues në bashkëpunim me MAPL-në do të punoj në zbatimin dhe përmbushjen e 4 zotimeve që rrjedhin nga plani i veprimit si: qeverisja dixhitale, të dhënat e hapura, pjesëmarrja qytetare dhe kundërkorrupsioni.
4. Për kryerjen e punëve si në pikën 3 të këtij Vendimi, komiteti koordinues do t'i raportoj Kryetarit të Kryeqytetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

**I DORËZOHET:**

- Anëtarëve të komitetit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
Përparim Rama

